



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
NJËSIA E INSPEKTORËVE**

Nr. 1172/12 prot.,

Datë 29.09. 2023

RAPORT I INSPEKTIMIT

**“MBI PROCEDURËN E SHPALLJES DHE ARSYETIMIT TË VENDIMEVE
GJYQËSORE TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM TIRANË, (DHOMA CIVILE) DHE GJYKATËS ADMINISTRATIVE
TË SHKALLËS SË PARË TIRANË”, TË INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË”**

Në zbatim të vendimit nr. 6/4, datë 13.04.2023, “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhomës Civile dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Tiranë, Shtator 2023

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

Titulli:

Raporti i inspektimit tematik me objekt "MBI PROCEDURËN E SHPALLJES DHE ARSYETIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, DHOMËS CIVILE DHE GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË",

Data e përgatitjes:

29/09/2023

Përgatitur nga:

Znj. Erjena Bashari

Znj. Joana Asimi



Për shqyrtim nga:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Z. Artur Metani

Miratoi ☐ Ndryshoi ☐ Ktheu ☐

Date

29/09/2023



I. Pjesa hyrëse

Në mbështetje të nenit 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (këtu e në vijim ILD) kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së Prokurorisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të detyrave të tij të përcaktuara në nenin 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronjat "dh", "ë" dhe "k", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka miratuar me vendimin nr. 6, datë 24.02.2023 "*Planin e inspektimeve për vitin 2023*", i ndryshuar.


Në këtë kuadër, nisur nga ushtrimi i kompetencave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përsa i përket kontrollit të veprimtarisë së magjistratëve dhe bazuar në vendimin nr. 6, datë 24.02.2023 "*Planin e inspektimeve për vitin 2023*", i ndryshuar, është planifikuar zhvillimi i një inspektimi tematik me objekt: "*Mbi procedurën e shpalljes dhe arsytimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhomës Civile dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*", për vendimet përfundimtare të dhëna nga këto gjykata për periudhën 01.09.2022–30.12.2022.

Për kryerjen e inspektimit sipas vendimit nr. 6/4, datë 13.04.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u angazhuan inspektorët, znj. Erjena Bashari dhe znj. Joana Asimi. Gjithashtu, me qëllim rritjen e efencës së grupit të inspektimit dhe miradministrimit të procesit, me të njëjtin vendim është caktuar si kryetar grupi inspektori znj. Erjena Bashari.

Arsyeja e inicimit të këtij inspektimi konsiston në një numër të lartë ankesash të paraqitura pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në të cilat ngriheshin pretendime për vonesa në zbardhjen e vendimeve gjyqësore përtej afateve ligjore ndaj magjistratëve gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe ndaj magjistratëve gjyqtarë të Gjykatës Administrative Tiranë. Nisur nga kjo dhe numri i madh i çështjeve që këto gjykata kanë në shqyrtim, Zyra e ILD-së nisi këtë inspektim tematik, për të krijuar një pasqyrë reale të gjendjes faktike të dorëzimit të vendimeve gjyqësore të përfunduara nga ana e magjistratëve.

Burimet e së drejtës, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së veprimtarisë së gjyqtarëve lidhur me objektin e inspektimit janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurave Administrative;
- Ligji "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";
- Ligji "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";



- Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 1830, datë 03.04.2001 “Për miratimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Gjyqësore”” ende në fuqi;
- Raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ-së për vitin 2022;
- Raport vjetor për vitin 2022 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Analiza vjetore e punës për vitin 2022 për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- Rregullore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë miratuar me Urdhrin nr. 209, datë 27.10.2017 të Kryetarit të Gjykatës;
- Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, datë 11.07.2017, miratuar nga Kryetari i Gjykatës;
- Kryerja e inspektimit është planifikuar sipas vendimit të inspektimit, për realizimin e tij në 4 faza:

- 1) Faza e parë: “Përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akte, si dhe zhvillimin e verifikimeve apo vizitave pranë gjykatave”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
 - a) Është hartuar plani i punës, i dakordësuar nga inspektorët, në datë 13.04.2023;
 - b) Janë hartuar shkresat drejtuar gjykatave objekt inspektimi, sipas një modeli të dakordësuar nga inspektorët, të cilat për të dy gjykatat janë nisur në datën 13.04.2023;
 - c) Është administruar informacioni dhe dokumentacioni sipas gjykatave përkatëse dhe përpunimi i tyre paraprak.
- 2) Faza e dytë: “Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
 - a) Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur dhe studimi i tyre;
 - b) Vlerësimin nëse duhet të merren të dhëna të tjera, informacioni dhe dokumentacion plotësues, të vlerësuar nga grupi i inspektorëve, nëpërmjet dërgimit të shkresës, komunikimit me anë të telefonit dhe vizitës në terren.
- 3) Faza e tretë: “Hartimi i Raportit të Inspektimit”, që ka përfshirë këto hapa:
 - a) Hartimi i raporteve të veçanta për secilën nga gjykatat që janë përfshirë në inspektim, sipas një model/strukture të njëjtë;
 - b) Hartimi i projekt raportit përfundimtar, i cili do të dërgohet për shqyrtim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pas shqyrtimit dhe daljes së Raportit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do të kalohet në fazën e fundit:

- 4) Faza e katërt: “Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe rezultateve të inspektimit”.
- Gjatë periudhës së zhvillimit të inspektimit janë konstatuar në mënyrë të përmblodhur problematika të lidhura me:

- Paraqitjen e paplotë të informacionit të kërkuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në lidhje me datat e komunikimeve të vendimeve palëve ndërgjyqëse, për shkak të mungesës së regjistrave të posaçëm për mbajtjen e këtyre të dhënave;
 - Paraqitjen me vonesë të informacionit dhe të dhënave të kërkuara në funksion të realizimit të këtij inspektimi nisur dhe nga ngarkesa e vazhdueshme në punë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - Paraqitjen me pasaktësi të informacionit dhe të dhënave nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për shkak të mungesës së regjistrave të posaçëm;
 - Ridërgimin e kërkesave (nëpërmjet emailit) me qëllim plotësimin e këtij informacioni, në rastin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - Nevojën për mbledhjen e informacionit nëpërmjet paraqitjes së inspektorëve pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- Inspektimi tematik përfshiu veprimtarinë e gjykatave subjekt të këtij inspektimi, për periudhën 01.09.2022 deri 30.12.2022.
 - Fokusi i inspektimit tematik u përqendrua kryesisht në tre drejtime kryesore:
 - (i) Datën e shpalljes së vendimit gjyqësor;
 - (ii) Datën e depozitimit të vendimit të arsyetuar në sekretari;
 - (iii) Datën e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve.

Qëllimi i këtij inspektimi është vlerësimi i praktikave të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile) dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me zbatimin e kritereve ligjore mbi shpalljen dhe depozitimin e vendimeve gjyqësore të arsyetuara në sekretari duke informuar me vërtetësi mbi gjendjen e organit të inspektuar.

Në këtë inspektim është vlerësuar veprimtaria e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile) dhe gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në respektimin e afateve ligjore të përcaktuara për shpalljen dhe dorëzimin e vendimeve të arsyetuara në sekretari.

Nisur nga problematikat e konstatuara gjatë objektit të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektimi tematik paraqet rëndësi në krijimin e një panorame të përgjithshme mbi zbatimin e afateve ligjore në zbardhjen e vendimeve gjyqësore dhe dorëzimit të dosjeve në kryesekretaritet e gjykatave, për të vijuar me komunikimet e vendimeve palëve, për të siguruar njoftimin në kohë dhe fillimin e afatit të ankimit, pa sjellë vonesa për palët ndërgjyqëse dhe në zbatim të përcaktimeve ligjore për këtë qëllim.

Inspektimi i zhvilluar mbi veprimtarinë e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile), mundësoi njohjen dhe

krijimin e një tabloje të përgjithshme mbi respektimin e afateve ligjore për arsyetimin e vendimeve gjyqësore të shpallura si dhe depozitimin e tyre së bashku me dosjet në sekretari nga magjistratët gjyqtarë. Nga të dhënat e administruara gjatë inspektimit për periudhën 01.09.2022 deri më 31.12.2022 rezultoi se:

- Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për periudhën 01.09.2022 deri më 31.12.2022 janë shpallur 1228 vendime gjyqësore, të cilat janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj gjykate. Nga këto 1147 vendime ose 93.5% e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit ligjor 7 ditor, 67 vendime ose 5.4 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda 10 ditëve, 13 vendime ose 1% e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda 18 ditëve dhe vetëm 1 vendim i shpallur është depozituar i arsyetuar në sekretari brenda 107 ditëve. Numri i gjyqtarëve sipas organikës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është 16, ndërsa numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë gjatë vitit 2022 është 12.1 gjyqtarë.
- Totali i vendimeve të shpallura nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për periudhën kohore 01.09.2022 deri më 31.12.2022 është 2613 vendime, nga të cilat të dorëzuara brenda afatit ligjor 20 ditor janë 1632 vendime ose 62.5 %; të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor janë 201 vendime ose 7.7 %; të dorëzuara brenda afatit 31-60 ditor janë 377 vendime ose 14.4 %; të dorëzuara brenda afati 61-90 ditor janë 154 vendime ose 5.9 %; të dorëzuara brenda afatit 91-120 ditor janë 78 vendime ose 3%; të dorëzuara brenda afatit 121-218 ditor janë 99 vendime ose 3.8%; të padorëzuara deri në datën 15.05.2023 janë 72 vendime ose 2.7 %. Kjo gjykatë ka funksionuar me 52% të numrit të gjyqtarëve që duhet të ketë sipas dekretit. Ngarkesa mesatare e një gjyqtari në këtë gjykatë ka qenë 1361 çështje.
- Numri total i vendimeve të dorëzuara me vonesë jashtë afatit ligjor të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është 909 vendime ose 35 % e vendimeve totale, *(në të cilat nuk përfshihen 72 vendime të padorëzuara në sekretari deri më datën 15.05.2023)*, nga totali i vendimeve të shpallura 2613. Rezulton se, pjesa më e madhe e vendimeve janë dorëzuar brenda afatit 31-60 ditor, në masën 41 % të totalit, duke vijuar me 22% të vendimeve brenda afatit 21-30 ditor, 17 % të vendimeve brenda afatit 61-90 ditor, 11 % të vendimeve brenda afatit 121-128 ditor dhe duke përfunduar me 9 % të vendimeve brenda afatit 91-120 ditë.
- Duke marrë në konsideratë ngarkesën mesatare të një gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me 1361 çështje, e cila ndikon në kohëzgjatjen e çështjeve të përfunduara, në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve të shpallura në sekretari rezulton se brenda afatit 120 ditor janë dorëzuar 89 % të vendimeve të shpallura. Pavarësisht afateve të parashikuara në ligjin procedural civil (neni 308 i K. Pr. Civile), rezulton se këto afate jo gjithmonë mund të zbatohen me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Pra, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit



të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se 89 % e vendimeve janë dorëzuar brenda afatit 120 ditore^[1], duke u konsideruar kështu në shumicën e rasteve, si koha e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar.

- Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë evidentohet fakti se në shumicën e rasteve është e pamundur të identifikohet momenti i kalimit të dosjes me vendimin e arsyetuar nga gjyqtari tek sekretari i seancës, për pasojë dhe respektimi i afateve procedurale për dorëzimin e dosjeve në sekretarinë gjyqësore nga sekretari i seancës.

Grupi i inspektorëve përgjegjës për kryerjen e inspektimi tematik me objekt: “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, (Dhomës Civile) dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, për vendimet përfundimtare të dhëna nga këto gjykata për periudhën 01.09.2022–30.12.2022 hartoi rekomandime për gjykatat subjekte të inspektimit mbi krijimin e regjistrave institucionale të cilat do të ndikonin në mbarëvajtjen e punës në këto gjykata si dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë mbi fillimin e verifikimeve në kuadër të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit për magjistratët gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një vendim të shpallur i cili është depozituar i arsyetuar në sekretari brenda 107 ditëve si dhe për magjistratët gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vendimet e shpallura të depozituara në sekretari pas 120 ditësh si dhe për vendimet e padorëzuara deri në datën 15.05.2023.

II. Objekti i kontrollit dhe analiza ligjore

Inspektimi tematik filloi me fazën e parë, hartimin e kërkesave për informacion dhe akteve drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, (Dhoma Civile) dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Nga ana e inspektorëve, në funksion të realizimit të inspektimit, janë administruar të dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku është mundësuar marrja e informacionit dhe dokumentacioni përkatës, nëpërmjet shkresës së dërguar nga kjo zyrë, me nr. 1854/4 prot., datë 15.05.2023^[2], materialet e dërguar në mënyrë elektronike me email^[3] si dhe

¹ Në një analizë më të hollësishme lidhur me numrin e dosjeve të shpallura por të padorëzuara brenda afatit ligjor, u gjet mesatarja e kohës që i është dashur gjyqtarëve për të plotësuar këtë detyrë. Për të arritur në gjetjen e afatit që i është dashur gjyqtarëve për dorëzimin e dosjeve, u procedua duke zbritur nga numri i përgjithshëm i dosjeve të shpallura, brenda periudhës së inspektimit, numrin e dosjeve të dorëzuara brenda afatit ligjor dhe numrin e dosjeve të padorëzuara ende deri në datën 15 maj 2023 dhe del shuma e përgjithshme e dosjeve të padorëzuara e cila është 909. Në bazë të kësaj shume u përllogarit me përqindje për afatet 21-30 ditore, 31-60 ditore, 61-90 ditore, 91-120 ditore dhe 120-218 ditore. Nga kjo përllogaritje doli që mesatarisht për periudhën 21-120 ditore, të jenë dorëzuar 89 % e vendimeve të shpallura dhe të përfunduara tej afatit ligjor.

² Regjistruar në ILD me nr. 1172/3 prot., datë 15.05.2023.

³ Email i kryesekretares znj. Mimoza Tafa datë 23.05.2023, email i kryesekretares znj. Mimoza Tafa datë 05.06.2023, email i kryesekretares znj. Mimoza Tafa datë 03.07.2023, email i kryesekretares znj. Mimoza Tafa datë 05.07.2023,

nëpërmjet një vizite të kryer nga inspektorët përgjegjës.

Nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni përkatës, sipas shkresës me nr. 5010/1 prot., datë 28.04.2023^[4] si dhe në mënyrë elektronike^[5].

Të dhënat e marra nga gjykatat sa më sipër lidhen me informacionin dhe dokumentacionin shkresor të mëposhtëm gjatë periudhës kohore objekt të inspektimit 01.09.2022–30.12.2022:

- i. Kopje të njësuar të numërorit të vendimeve të shpallura në harkun kohor 01.09.2022–30.12.2022;
- ii. Informacion nominal për gjyqtarët e secilës gjykatë, në lidhje me numrin e çështjeve të shpallura dhe momentin e dorëzimit të tyre në kryesekretari, për harkun kohor 01.09.2022–30.12.2022;
- iii. Çdo dokument që vërteton dorëzimin e vendimeve të arsyetuara në kryesekretarinë e gjykatës;
- iv. Informacion statistikor për periudhën 01.09.2022–30.12.2022, për trendin e dorëzimit të vendimeve të shpallura;
- v. Informacion mbi datën e nisjes së njoftimit të vendimit të arsyetuar, palëve pjesëmarrëse në proces, nga kryesekretaria e gjykatës;
- vi. Çdo informacion tjetër, i cili do të dalë i nevojshëm gjatë kryerjes së inspektimit.


Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analiza e të dhënave të marra nga zyrat e gjykatave, është përqendruar në drejtim të (i) datës së shpalljes së vendimit gjyqësor, (ii) datës në të cilën dosja e plotë gjyqësore së bashku me vendimin përfundimtar të arsyetuar është dorëzuar në kryesekretari, (iii) datën e komunikimit të vendimit gjyqësor palëve ndërgjyqëse.

Trajtimi i këtyre të dhënave, është bazuar në analizën dhe interpretimin e dispozitave përkatëse të Kushtetutës të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë; të Kodit të Procedurave Administrative; të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 1830, datë 03.04.2001 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Gjyqësore”, të Raportit të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ-së për vitin 2022; të Raportit vjetor për vitin 2022 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të analizës vjetore të punës për vitin 2022 për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; të Rregullores së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë miratuar me Urdhrin nr. 209, datë 27.10.2017 të Kryetarit të Gjykatës; të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë” datë 11.07.2017,

email i kryesekretares znj. Mimoza Tafa datë 06.07.2023, email i Nëpunëses Civile Gjyqësore pranë Zyrës së Kancelarit, znj. Lorena Bellovoda datë 06.07.2023, email i Kancelarit z. Donald Xhelili datë 06.07.2023.

⁴ Regjistruar në ILD me nr. 2806/1 prot., datë 07.07.2021.

⁵ Email i kryesekretares znj. Selvana Gogo datë 06.07.2023.



miratuar nga Kryetari i Gjykatës ku parashikohen dispozitat përkatëse dhe afatet për depozitimin e vendimeve gjyqësore të arsyetuara së bashku me dosjet në sekretari, rregullat për mbajtjen e regjistrave pranë sekretarisë ku të evidentohet data e shpalljes së vendimit si dhe data e depozitimit të vendimit të arsyetuar së bashku me dosjen në sekretari.

Në këtë analizë është marrë në konsideratë edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së e cila thekson se u takon shteteve kontraktuese të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që organet kompetente të mund të plotësojnë kërkesat e nenit 6 të Konventës, duke përfshirë dhe detyrimin për trajtimin e çështjeve brenda një kohe të arsyeshme.^[6]

Me qëllimin që analizimi i të dhënave të mbledhura të ishte sa më gjithëpërfshirës, objektiv dhe shterues, nga grupi i inspektimit u morën edhe të dhëna të përgjithshme të sistemit të drejtësisë në vend, konkretisht raportet vjetore të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kështu, në raportin vjetor të KLGJ-së për vitin 2022, referuar gjendjes së sistemit gjyqësor gjatë vitit 2022 Këshilli ndër të tjera shprehet se:

- Pjesa më e madhe e gjykatave kanë funksionuar me kapacitet të reduktuar të gjyqtarëve, nën 70% (25 nga 38 gjykata), ndërsa në nivel kombëtar vetëm 56% e organikës së gjyqtarëve kanë qenë efektivisht në detyrë gjatë vitit 2022;
- Ngarkesa e punës në gjykata është përballuar nga vetëm 228 gjyqtarë ose 8.2 gjyqtarë për 100.000 banorë. Ky raport është më pak se 40% e normës evropiane (22.2 gjyqtar për 100.000 banorë)^[7];
- Gjykatat kanë bërë përpjekje për të ruajtur ritmin e zgjidhjes së çështjeve, mesatarja e normës së likuidimit të çështjeve në rang vendi është rritur duke shënuar një normë prej 104% (krahasuar me normën mesatare 68% në 2021) me qëllim mbajtjen nën kontroll të rritjes së stokut, tentativa të cilat nuk kanë sjellë rezultat pasi shënohet një rritje prej 31% të çështjeve në pritje të gjykimit në rang vendi;
- Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar në rang vendi, gjatë vitit 2022, ka qenë pothuajse 561 çështje për gjyqtar, që shënon një rritje me 25 çështje (536 në 2021) më tepër krahasuar me një vit më parë.^[8]

Në vijim është pasqyruar analiza ligjore me të dhënat përkatëse që janë përpunuar mbi secilin subjekt të inspektimit, pas trajtimit të informacioneve të dërguara nga gjykatat, raportet vjetore të punës së secilës gjykatë, informacionit të trajtuar në raportet vjetore të KLGJ-së për këto gjykata. Pjesë e analizës ligjore për secilën gjykatë është situata aktuale që rezulton nga gjetjet e inspektimit si, ngarkesa e gjykatës duke përfshirë çështjet e mbartura nga viti i mëparshëm, ato të regjistruara rishtazi, si dhe gjendja reale e burimeve njerëzore të gjykatave.

⁶ Shiko vendimin: Mishgjoni K. Shqipërisë nr. 18381/05, datë 7 dhjetor 2010 para 59; Makarova K. Rosisë, nr. 23554/03, datë 1 tetor 2009.

⁷ Popullsia e Republikës së Shqipërisë në datën 1 janar 2022 rezultojnë 2.793.592 banorë, sipas të dhënave të fundit të INSTAT, <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/publiki%met/2022/popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-1-janar-2022/>

⁸ Fq 9



➤ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

Në përgjigje të kërkesës së ILD-së për të dhëna në kuadër të inspektimit tematik Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë^[9] vendosi në dispozicion kopje të numërorit të vendimeve të shpallura për periudhën 01.09.2022–30.12.2022; tabelën me të dhënat për secilin gjyqtar të kësaj gjykate lidhur me numrin e çështjeve të shpallura dhe momentin e dorëzimit të tyre për periudhën 01.09.2022–30.12.2022; tabelën me të dhënat statistikore për trendin e dorëzimit të vendimeve të shpallura për secilin gjyqtar për periudhën 01.09.2022–30.12.2022.

Gjithashtu Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë parashtroi se nga verifikimet në kryesekretarinë e kësaj gjykate, dokumenti që provon dorëzimin e vendimeve në kryesekretari është fleta e numërorit të vendimeve. Nga shqyrtimi i fletës së numërorit të vendimeve konstatohet se në të pasqyrohen të dhëna në lidhje me gjyqtarin që ka gjykuar çështjen, numrin dhe datën e shpalljes së vendimit, numrin dhe datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë, palët ndërgjyqëse, objekti i kërkesëpadisë, lloji i dispozitivit të vendimit, numri i anëtarëve të trupit gjykues, numri i përgjithshëm i seancave të zhvilluara dhe data e dorëzimit të dosjes. Nga verifikimet në kryesekretarinë e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë rezultoi se, data e nisjes së vendimit të arsyetuar palëve, shënohet në kopjen e dëftesës së komunikimit e cila lëshohet vetëm në një kopje, i dërgohet secilës palë pjesëmarrëse në gjykim dhe këto akte pas konfirmimeve zyrtare nga palët bëhen pjesë e inventarizimit të dosjeve gjyqësore.

Gjatë kryerjes së inspektimit pas kërkesës së inspektorëve përgjegjës me email-in e datës 06.07.2023 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë përcjellë kopje të raportit vjetor për vitin 2022 nga ku rezultoi se, në këtë gjykatë gjatë vitit 2022 janë gjykuar një numër i konsiderueshëm çështjesh gjyqësore, ngarkesë që është përballuar nga gjyqtarët e kësaj gjykate me efikasitet pavarësisht pakësimit të numrit të gjyqtarëve në organikën e kësaj gjykate. Sipas raportit vërehet një trend në rritje të çështjeve gjyqësore të regjistruara pranë kësaj gjykate në krahasim me vitin 2021.

Nga raportit i Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ-së për vitin 2022^[10] konstatohet se numri i gjyqtarëve sipas organikës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është 16, ndërsa numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë gjatë vitit 2022 është 12.1. Nga ky raport rezultoi se ngarkesa e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka patur një rritje në krahasim me vitin 2021 me një mesatare prej 210 çështje më tepër për të gjykuar në 2022. Ndërkohë që ngarkesa mesatare vjetore e një gjyqtari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është 763 çështje të përpunuara.

⁹ Me shkresën nr. 5010/1 prot., datë 28.04.2023 regjistruar pranë Ild-së me nr. 1172/2, datë 02.05.2023.

¹⁰ Marrë nga faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.



➤ **Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë**

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në përgjigjen e saj^[11] vendosi në dispozicion të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, fotokopjen e njëzuar me origjinalin të numërorit të vendimeve civile të shpallura në harkun kohor 01.09.2022 deri më 31.12.2022 në të cilën pasqyrohen të dhëna në lidhje me gjyqtarin që ka gjykuar çështjen, numrin dhe datën e shpalljes së vendimit, datës së paraqitjes së kërkesëpadisë në gjykatë, numrin dhe datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë, palët ndërgjyqëse, objekti i kërkesëpadisë, përmbledhje e dispozitivit të vendimit, trupin gjykues, anëtarët e trupit gjykues, numrin e përgjithshëm të seancave të zhvilluara, datën e dorëzimit në kryesekretari të dosjes gjyqësore dhe vendimit të arsyetuar, datën e nisjes në gjykatën e Apelit dhe gjykatën e Lartë, si dhe për shkak të ngarkesës në punë, të dhënat tabelore mbi datën e dorëzimit të vendimeve të arsyetuara në sekretari dhe mbi datën e komunikimit të vendimeve të arsyetuara palëve pjesëmarrëse në proces, janë përcjellë në mënyrë elektronike në datat 23.05.2023 dhe 05.06.2023.

Gjatë kryerjes së inspektimit pas kërkesës së inspektorëve përgjegjës me email-in e datës 06.07.2023^[12], Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, përcjellë kopje të analizës vjetore të punës për vitin 2022, ku përmendet se është përballuar një volum shumë i madh pune me një numër të reduktuar gjyqtarësh, prej 21 gjyqtarësh, në (Dhomën Civile), në fund të vitit 2022 dhe 16 gjyqtarë në (Dhomën Penale), ardhur kjo si shkak i procesit të “Rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”, daljes në pension apo dorëheqjeve të gjyqtarëve. Përveç ngarkesës së çështjeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, janë menaxhuar edhe komandimet e gjyqtarëve në Gjykatat e Rretheve të tjera Gjyqësore, si dhe në Gjykatën e Krimeve të Rënda.

Sipas analizës vjetore për vitin 2022 (Dhoma Civile) ndahet në 2 seksione, respektivisht seksioni (civil-tregtar) dhe seksioni (familjar) të cilët shqyrtojnë të gjitha llojet e çështjeve civile, familjare, tregtare që parashikohen përkatësisht në Kodin Civil, në Kodin e Familjes, Kodin e Punës, në ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, ligjin “Për Falimentin”, ligjin “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, si dhe në ligje të tjera të veçanta, ku përfshihen shprehimisht çështje që hyjnë në juridiksionin dhe kompetencën e shqyrtimit të kësaj gjykate. Seksioni civil tregtar përbëhet nga 17 gjyqtarë dhe seksioni familjar përbëhet nga 4 gjyqtarë.

Nga Raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ-së për vitin 2022^[13] konstatohet se numri i gjyqtarëve sipas organikës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është 76, ndërsa numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë gjatë vitit 2022 është 39.5. Sipas raportit të sipërcituar ngarkesa mesatare e një gjyqtari në këtë gjykatë ka qenë 1361 çështje. Për grupin e gjykatave të rrethit gjyqësor, ngarkesa totale e çështjeve të pashqyrtuara nga viti 2021 është 36,590 çështje nga të cilat 28,392

¹¹ Me shkresën nr. 1854/4 prot., datë 15.05.2023 regjistruar pranë Ild-së me nr. 1172/3, datë 15.05.2023.

¹² Në të njëjtën datë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë përcjellë Rregulloren e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹³ Marrë nga faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

janë çështje civile dhe 8,198 çështje penale. Nga këto 53% të backlogut (19,374 çështje) janë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Gjatë vitit 2022 janë regjistruar në Gjykatat e Shkallës së Parë 96,596 çështje të reja (13% më pak sesa në vitin 2021), edhe këtu peshën më të madhe me 34,382 çështje (36% e totalit) e mban Gjykata e Tiranës. Si pasojë e treguesve të efencës, në fund të vitit 2022 stoku është rritur me 4276 çështje. Në 31 dhjetor 2022 mbeten në pritje të gjykimit 40,866 çështje, nga të cilat 47 % (19,275 çështje) i përkasin Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Lidhur me ngarkesën e gjykatave e cila përbëhet nga dy komponentë, stoku i çështjeve të mbartura nga një vit më parë dhe nga çështjet e regjistruara gjatë vitit të referencës, rezulton se gjatë periudhës së inspektimit, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka numrin më të madh të çështjeve të mbartura (backlog) për gjykatat e rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm, duke filluar me vitin 2019 me 37% të totalit të çështjeve të mbartura, në vitin 2020 me 42% të totalit, në vitin 2021 me 53% të totalit të çështjeve të mbartura, po ashtu ka numrin më të madh të çështjeve të reja të regjistruara, duke evidentuar vetëm vitin 2022, në 34,382 çështje të reja ose 36% e totalit për gjykatat e rrethit gjyqësor.

Në raportin vjetor të KLGJ-së për vitin 2022, është evidentuar se:

- ✚ për grupin e gjykatave të rrethit gjyqësor, ngarkesa totale e çështjeve të pashqyrtuara nga viti 2021 (backlog-u) është 36,590 çështje (28 % më shumë krahasuar me vitin paraardhës), nga të cilat 53% (19,374 çështje) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- ✚ si pasojë e treguesve të efencës, në fund të vitit 2022 stoku është rritur me 4276 çështje. Në 31 dhjetor 2022 mbeten në pritje të gjykimit 40,866 çështje, nga të cilat 47 % (19,275 çështje) i përkasin Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Duke vijuar me analizën e burimeve njerëzore, për vitin 2022 rezulton se kjo gjykatë nuk ka funksionuar me organikë të plotë, pasi faktikisht ka 39 gjyqtarë ose 52 %, pra gjysmën e organikës së saj, në raport me organikën 76 gjyqtarë (numrin e gjyqtarëve sipas dekretit), të pasqyruar në tabelën e mëposhtme, së bashku me kriterin e ngarkesës mesatare të gjyqtarëve.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë				
Viti	Nr. i gjyqtarëve sipas dekretit	Nr. i gjyqtarëve në fakt	Nr. i gjyqtarëve në %	Ngarkesa mesatare e gjyqtarëve (Treguesi WR)
2019	76	66,82	87,92	643
2020	76	61.08	80%	617
2021	76	51.16	67%	1066
2022	76	39	52%	1361

Bashaj

[Signature]

Në kuadër të një analize të gjithanshme mbi situatën faktike të gjendjes së gjykatave është i domosdoshëm krijimi i një panorame të plotë mbi legjislacionin vendas dhe ndërkombëtar, si dhe praktikën gjyqësore në mbështetje të objektit të inspektimit, *“Shpalljes, arsytimit të vendimeve dhe dorëzimit të tyre për t’jua komunikuar palëve, brenda një afati të arsyeshëm”*.

Legjislacioni shqiptar ka përcaktuar qartë detyrimet e magjistratëve në realizimin e detyrave të tyre funksionale, kështu në nenin 3, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, është parashikuar se sjellja e magjistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes dhe forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Nëse magjistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien dhe sigurimin e drejtësisë në shoqëri ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike. Në referim të jurisprudencës së Gjykatës së Lartë^[14] dhe asaj Kushtetuese^[15], gjykatat kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm *“të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm”*.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 12, datë 05.03.2012 ka arsyetuar se: *“...Arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke patur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuarin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit...”*^[16]. Gjykata Kushtetuese ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 5, datë 12.12.2013^[17], kanë elaboruar rrethanat në të cilat vonesat në arsytimin e vendimit gjyqësor passjellin përgjegjësi disiplinore për gjyqtarin. Në këtë vendim gjykata ka referuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së. Sipas këtij vendimi, gjykatat kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm *“të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm”*. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se

^[14] Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 12.12.2013.

^[15] Vendimi nr. 8, datë 16.03.2011; Vendimi nr. 23, datë 04.11.2008; Vendimi nr. 11, datë 02.04.2008.

^[16] Shih vendimin nr. 18, datë 19.07.2005 dhe nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

^[17] Çështja me palë: paditës N. T., kundër të paditurit KLD-së, me objekt padi: kundërshtim vendimi të KLD-së për shkarkimin e paditësit nga detyra e gjyqtarit.

respektimi i dispozitave procedurale të cilat lidhen me dorëzimin e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që të mos cenohen të drejtat kushtetuese të palëve në proces dhe të mos pengohet dhënia e drejtësisë, është e lidhur drejtpërsëdrejti me respektimin e parimit të zhvillimit dhe përfundimit të një procesi brenda një afati të arsyeshëm. Referuar parimeve të së drejtës vendase dhe ndërkombëtare, me afat të arsyeshëm ligjor do të kuptohet jo vetëm koha që merr shqyrtimi i çështjes deri në dhënien/shpalljen e vendimit përfundimtar nga ana e gjykatës, por edhe koha që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar.

Një vendim i vonuar madje mund të zhbëjë edhe vetë arsyen për të cilën është dhënë vendimi, pasi dhënia e tij në vonesë, mund të bëjë që ai të jetë krejt i pavlefshëm për palën e interesuar. Parimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm përbën një nga elementët e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, (KEDNJ), dhe në referim të praktikës së GJEDNJ-së është përcaktuar se periudha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil shtrihet, që nga momenti i ngritjes së padisë tek momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor.^[18]

Në Kodin e Procedurës Civile (*neni 308*) është parashikuar afati 20 (njëzet) ditë i arsyetimit të vendimit. Ky afat synon disiplinimin në mënyrë të arsyeshme të punës së gjykatës në lidhje me arsyetimin e vendimit. Gjykata duhet të marrë një kohë të arsyeshme për arsyetimin dhe dorëzimin e vendimit në sekretari, kjo e fundit njofton kopjen e vendimit palëve të interesuara. Vendimi përfundimtar i gjykatës duhet t'u njoftohet palëve në zbatim të parimit të procesit të rregullt ligjor. Në lidhje me njoftimin e vendimit duhen mbajtur parasysh nenet 171/a (3)^[19] dhe 316^[20] të Kodit të Procedurës Civile.


Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vazhdim të analizës së mësipërme, vlerësojnë të theksojnë edhe njëherë se jo në çdo rast mosrespektimi i afateve procedurale të përmendura më lart e çon gjyqtarin përpara procedimit disiplinor. Jo në çdo rast shkeljet që konstatohen në veprimtarinë e gjyqtarit dhe në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e tij për të dorëzuar brenda një afati të arsyeshëm vendimet e arsyetuara do të konsiderohen si shkelje që kanë çuar në humbjen e besimit dhe kredibilitetit ndaj gjyqtarit apo akte që kanë diskredituar rëndë figurën dhe sjelljen e tij. Që këto shkelje të konsiderohen si të tilla duhet të ketë një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, të tilla që kalojnë “kufirin e të arsyeshmes”, dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet, duke çuar në cenimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij.

Vonesat e pajustificuara në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara pengojnë ecurinë normale të procesit të dhënies së drejtësisë dhe për pasojë dëmtojnë të drejtën e subjekteve për një proces të rregullt gjyqësor; duke iu cenuar palëve të drejtën për të patur arsyetimin e vendimit në mënyrë që

¹⁸. <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-65116>

¹⁹ “...Vendimet e shpallura jashtë seancës dhe ato, ndaj të cilave lejohet ankim i veçantë u komunikohen palëve të interesuara nga sekretari i seancës jo më vonë se tre ditë nga shpallja e tyre...”.

²⁰ “...Vendimet përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, brenda tre ditëve nga marrja e vendimit ose, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tre ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar...”.



të vlerësojnë kushtet e marrjes së tij dhe eventualisht për të disponuar me ushtrimin e së drejtës së ankimit; duke dëmtuar dukshëm imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut në të, për sa kohë tejkalimi i afateve logjike dhe normale, është thuajse i barabartë me mungesën e drejtësisë. Mungesa e arsyeve mbi të cilat bazohet vendimi për një afat të gjatë cenon thelbin e të drejtës së ankimit, të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës^[21].

Nga shqyrtimi i të dhënave objekt inspektimi të pasqyruara në tabelën përmbledhëse (fq., nr. 12), rezulton se numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është ulur, si pasojë e vendimmarrjeve të procesit të rivlerësimit kalimtar, daljes në pension dhe dorëheqjeve të gjyqtarëve. Ky proces natyrshëm ka krijuar kosto për qytetarët në tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore duke krijuar një problematikë që ka të bëjë me sistemin në tërësi, duke bërë që gjyqtarët që ushtrojnë efektivisht detyrën të përballen me një volum të shtuar pune e duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rendimentin dhe eficientësinë e gjyqtarit. Kjo është një situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor për shkak të vakancave të krijuara e mosplotësimit të organikës.

Sa i përket problematikave të konstatuara gjatë inspektimit të hasura në lidhje me arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore, duhet mbajtur në konsideratë se një faktor i rëndësishëm është edhe situata reale e administratës gjyqësore në gjykatat e vendit. Kjo e lidhur me mënyrën e organizimit të punës, realizimit të detyrave nga stafi përgjegjës i administratës gjyqësore, përgjegjësia e sekretarit të seancës për dorëzimin e dosjes, si dhe e sekretarit gjyqësor për plotësimin e librit të pasqyrimin të lëvizjes së dosjeve, si psh., kalimi i dosjes gjyqësore nga momenti i arsyetimit nga gjyqtari tek dorëzimi i arsyetuar në sekretarinë gjyqësore. Gjatë inspektimit u konstatua që libri i pasqyrimin të lëvizjes së dosjeve (*pra kalimi i dosjes gjyqësore pas arsyetimit të vendimit nga gjyqtari tek sekretari i seancës*) është në formën e një blloku që plotësohet nga sekretari i seancës në funksion të mbarëvajtjes së punës.

Në zbatim të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me Urdhrin nr. 209, datë 27.10.2017 ka miratuar “Rregulloren e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, me anë të të cilës bashkërendohen në një akt të vetëm, standardizimin e veprimtarisë së administrimit gjyqësor. Në nenin 24 të rregullores është parashikuar se: 1/ u) “...sekretari gjyqësor plotëson librat e pasqyrimin të lëvizjes së dosjeve. 2. Sekretari gjyqësor, kujdeset që regjistrat, numëratoret dhe librat, të kenë fletë të numërtuara dhe të konfirmuara në fund nga nënshkrimi i Kancelarit krahas nënshkrimit të sekretarit përkatës. 3. Sekretari gjyqësor kërkon respektimin e afateve procedurale për dorëzimin e dosjeve në sekretarinë gjyqësore, si dhe kontrollon rregullësinë dhe etikën e dosjes gjyqësore...”.

Marrë në konsideratë sa më sipër, pavarësisht parashikimeve ligjore evidentohet fakti se në shumicën e rasteve është pamundur të identifikohet momenti i kalimit të dosjes me vendimin e

²¹ Shih vendimin nr. 289, datë 18.04.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në çështjen L. Hoxha, kundër KLD-së.

arsyetuar nga gjyqtari tek sekretari i seancës, për pasojë dhe respektimi i afateve procedurale për dorëzimin e dosjeve në sekretarinë gjyqësore nga sekretari i seancës. Në funksion të respektimit të afateve procedurale për dorëzimin e dosjeve në sekretarinë gjyqësore, do të ishte e udhës që libri i pasqyrimit të lëvizjes së dosjeve të mbante datën e dorëzimit të dosjes nga gjyqtari tek sekretari i seancës, nga sekretari i seancës tek sekretari gjyqësor, të numërtohet në çdo fletë, të nënshkruhet nga kancelari/sekretari i seancës/sekretari gjyqësor.

Ndërsa në rregulloren e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nuk është përcaktuar rregullimi i hollësishëm normativ i regjistrave, i llojeve të tyre, numërorëve dhe librave që pasqyrojnë lëvizjen e dosjeve, për realizimin e detyrave nga administrata gjyqësore.

III. Gjetjet e inspektimit


Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analizimit të të dhënave të grumbulluara nga ky inspektim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile), trajtimi në mënyrë shteruese i problematikave të dala gjatë realizimit të inspektimit si dhe nga këqyrja e bërë nga grupi i inspektimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton se:

➤ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë


Grupi i inspektimit pasi shqyrtoi të dhënat shkresore të nisura nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, i kryqëzoi me të dhënat tabelore duke nxjerrë një informacion fillestar mbi mënyrën e dorëzimit të dosjeve në kryesekretari, veprimtarinë e sekretarisë në momentin e dorëzimit të dosjeve gjyqësore të përfunduara dhe gjithashtu një trend të përgjithshëm mbi afatet e përgjithshme të dorëzimit të dosjeve në kryesekretarinë e kësaj gjykate. Nga analiza vjetore e kësaj gjykate dhe e KLGJ-së për vitin 2022 bëhet me dije se kjo gjykatë ka një mesatare prej 763 çështjesh për secilin gjyqtar efektiv.

Të dhënat e vendosura në dispozicion nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, janë përpunuar dhe trajtuar në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar “Shpallja dhe depozitimi i vendimit ku përcaktohet se: *“1. Vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar. 2. Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 (pesë) ditë. 3. Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore”*. Nga përpunimi rezultoi se për periudhën e inspektuar nga data 01.09.2022 deri më datë 31.12.2022, mbi vendimet e shpallura dhe dorëzimin e dosjeve gjyqësore, gjendja është si vijon:

- Për periudhën 01.09.2022 deri më 31.12.2022 në këtë gjykatë janë shpallur 1228 vendime gjyqësore, të cilat janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj gjykate.
- Respektivisht janë dorëzuar:
 - Brenda afatit 7 ditor të parashikuar në ligj, 1147 vendime pra 93.5 % e totalit të vendimeve.



- Nga 7-10 ditë janë dorëzuar 67 vendime pra 5.4 % e totalit të vendime.
- Nga 10-18 ditë janë dorëzuar 13 vendime pra 1 % e vendimeve të shpallura.
- Mbi 18 (107 ditë) ditë është dorëzuar vetëm 1 vendim pra 0.1 % e vendimeve të shpallura. Ky vendim është dhënë nga magjistratja Etleva Gjamo, gjyqtare e deleguar nga Korça, për një çështje e cila është dorëzuar me vonesë.



➤ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Grupi i inspektimit pasi shqyrtoi të dhënat shkresore të nisura nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i kryqëzoi me të dhënat tabelare duke nxjerrë një informacion fillestar mbi mënyrën e dorëzimit të dosjeve në kryesekretari, veprimtarinë e sekretarisë në momentin e dorëzimit të dosjeve gjyqësore të përfunduara dhe gjithashtu një trend të përgjithshëm mbi afatet e përgjithshme të dorëzimit të dosjeve në kryesekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Të dhënat e vendosura në dispozicion nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, janë përpunuar dhe trajtuar në zbatim të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se: *“Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Gjyqtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën “kundër” dhe nënshkruan vendimin. Gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se 20 (njëzet) ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në 20 (njëzet) ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai del kundër.”*


Totali i vendimeve të shpallura për periudhën kohore 01.09.2022 deri më 31.12.2022 është 2613 vendime nga të cilat sipas klasifikimit të periudhës kohore nga shpallja në dorëzimin e vendimeve rezultoi:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 20 ditor:	1631 vendime ose 62.3 %.
Të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor:	201 vendime ose 7.7 %.

Bashay

[Signature]

Të dorëzuara brenda afatit 31-60 ditor:	378 vendime ose 14.5 %.
Të dorëzuara brenda afatit 61-90 ditor :	153 vendime ose 5.9 %.
Të dorëzuara brenda afatit 91-120 ditor:	69 vendime ose 2.6 %.
Të dorëzuara brenda afatit 121-218 ditor:	79 vendime ose 3%.
Të padorëzuara deri në datën 15.05.2023:	102 vendime ose 4 %.



Gjatë përpunimit të të dhënave të dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nga inspektorët përgjegjës u vunë re problematika në korrespondimin e datave të dorëzimit të dosjeve në kryesekretari dhe të njoftimeve të vendimeve nga ana e kryesekretarisë, palëve ndërgjyqëse. Një pjesë e vendimeve të padorëzuara në kryesekretari rezultojnë të njoftuara palëve, ose kishte mospërputhje të datës së dorëzimit dhe datës së njoftimit të vendimit palëve, ku data e njoftimit të palëve rezultonte përpara datës së dorëzimit të vendimeve.

Me synim verifikimin e të dhënave dhe saktësimin e informacionit inspektorët përgjegjës pas vendimit të ILD-së me nr. 1172/5 prot., datë 19.06.2023 realizuan një inspektim në vend, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë më datë 26.06.2023.

Pas këqyrjes në vend të regjistrave të dorëzimit, ekzaktësisht numërorit të vendimeve të shpallura që shërben edhe për të shënuar datat e dorëzimit të dosjeve në kryesekretari, librave të postës për të parë datat e nisjes së komunikimeve të vendimeve për ato dosje që nuk ndodheshin pranë gjykatës për shkak të ankimit, modelit të një blloku të sekretares gjyqësore për kalimin e dosjes së përfunduar nga gjyqtari i çështjes te sekretarja gjyqësore e mandej dorëzimi në kryesekretari dhe disa dosjeve gjyqësore me qëllim kryerjen e verifikimit të të dhënave në mënyrë shteruese, grupi i inspektimit i la detyrë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, saktësimin e të dhënave mbi datën e dorëzimit të vendimeve gjyqësore dhe mbi datën e komunikimit të vendimeve dhe dërgimin e tyre pranë

[Signature]

[Signature]


Inspektorit të Lartë të Drejtësisë brenda datës 30.06.2023^[22].

Plotësimi i të dhënave nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nuk u realizua brenda afatit të lënë nga inspektorët përgjegjës, por u dërguan në mënyrë elektronike me email-e në datat 03.07.2023, 04.07.2023 dhe 06.07.2023. Pas përpunimit të të gjitha të dhënave të administruara gjatë inspektimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezultoi si vijon:

Totali i vendimeve të shpallura për periudhën kohore 01.09.2022 deri më 31.12.2022 është **2613** vendime. Nga të cilat sipas klasifikimit të periudhës kohore nga shpallja në dorëzimin e vendimeve rezultoi:

Të dorëzuara në afat, pra brenda afatit 20 ditor:	1632 vendime ose 62.5 %.
Të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor:	201 vendime ose 7.7 %.
Të dorëzuara brenda afatit 31-60 ditor:	377 vendime ose 14.4 %.
Të dorëzuara brenda afatit 61-90 ditor:	154 vendime ose 5.9 %.
Të dorëzuara brenda afatit 91-120 ditor:	78 vendime ose 3 %.
Të dorëzuara brenda afatit 121-218 ditor:	99 vendime ose 3.8%.
Të padorëzuara deri në datën 15.05.2023:	72 vendime ose 2.7 %.

Panoramën e gjendjes së dorëzimit të vendimeve të arsyetuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe verifikimit fillestar nga grupi i inspektimit paraqitet si në grafikun vijues:



Në vijim të analizës së mësipërme, rezulton se, numri total i vendimeve të dorëzuara me vonesë jashtë afatit ligjor të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është 909 vendime ose 35 % e vendimeve totale, (në të cilat nuk përfshihen 72 vendime të padorëzuara në

²² Sipas procesverbalit nr. 4383/1 prot., datë 26.06.2023.

sekretari deri më datë 15.05.2023), nga totali i vendimeve të shpalluara 2613. Rezulton se, pjesa më e madhe e vendimeve janë dorëzuar brenda afatit 31-60 ditor, në masën 41 % të totalit, duke vijuar me 22% të vendimeve brenda afatit 21-30 ditor, 17 % të vendimeve brenda afatit 61-90 ditor, 11 % të vendimeve brenda afatit 121-128 ditor dhe duke përfunduar me 9 % të vendimeve brenda afatit 91-120 ditë.

Në përpunimin e të dhënave që rezultuan nga gjetjet e inspektimit, janë analizuar të dhënat e raporteve vjetore të KLGJ-së 2019–2022,^[23] e cila kryen monitorimin e produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave bazuar në metodologjinë^[24] e CEPEJ-it^[25], (të 5 indikatorëve apo treguesve të funksionimit të gjykatës), dhe konkretisht për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, konkludon se është gjykata më e madhe në vend sa i përket shtrirjes territoriale dhe numrit të popullsisë në territorin në të cilin shtrihet juridiksioni i saj dhe me një numër të lartë çështjesh.

Në vijim të analizës së mësipërme, ngarkesa në punë që shoqëron sot magjistratët, lidhur edhe me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, është një kriter objektiv që mbahet parasysh me numrin total të çështjeve civile dhe kohën e nevojshme për të arsyetuar vendimet gjyqësore të dhëna, ndaj dhe bazuar në këtë kriter objektiv, koha që i është dashur magjistratëve për të arsyetuar vendimet gjyqësore, i shërben jo vetëm rritjes së cilësisë në aspektin përmbajtësor të vendimit gjyqësor të dhënë në drejtim të palëve ndërgjyqëse që ky vendim i drejtohet, por edhe forcimit të besimit të publikut për një gjykim të drejtë, ku thelbi i këtij parimi është një vendim gjyqësor i mirëarsyetuar.

Duke marrë në konsideratë ngarkesën mesatare të një gjyqtari në këtë gjykatë 1361 çështje, e cila ndikon në kohëzgjatjen e çështjeve të përfunduara, në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve të shpalluara në sekretari dhe kryqëzuar me të dhënat e tabelës së mësipërme (fq., 19), rezulton se brenda afatit 120 ditor janë dorëzuar 89 % të vendimeve të shpallura. Pra, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se, 89 % e vendimeve janë dorëzuar brenda afatit 120 ditor^[26], duke u konsideruar kështu në shumicën e rasteve, si koha e arsyeshme që i

²³ <https://klgj.al/wp-content/uploads/2020/09/RAPORTI-VJETOR-2019-pdf.pdf>
<https://klgj.al/wp-content/uploads/2021/06/Raporti-Vjetor-KLGJ-2020.pdf>
<https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/04/RAPORT-VJETOR-2021.pdf>
<https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/07/RAPORT-VJETOR-2022-shkarko.pdf>

²⁴ <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/04/RAPORT-VJETOR-2021.pdf>


Raporti vjetor 2021 i KLGJ-së, faqja 22-23: “Në zbatim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, dhe nevojës imediate për unifikimin e të dhënave statistikore të raportuara nga gjykatat, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në shkurt 2021, miratoi “Udhëzuesin për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave”. Ai është produkt i një bashkëpunimi të gjatë me partnerë të huaj dhe ekspertë të metodologjisë së konsoliduar dhe unifikuar të CEPEJ. Udhëzuesi ka për qëllim vendosjen e rregullave standarde, të unifikuara për të gjitha gjykatat, për mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe raportimit të tyre, duke synuar një analizë të saktë të sistemit gjyqësor në tërësi.”

²⁵ CEPEJ është Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë.

²⁶ Në një analizë më të hollësishme lidhur me numrin e dosjeve të shpallura por të padorëzuara brenda afatit ligjor, u gjet mesatarja e kohës që i është dashur gjyqtarëve për të plotësuar këtë detyrë. Për të arritur në gjetjen e afatit që i është dashur gjyqtarëve për dorëzimin e dosjeve, u procedua duke zbritur nga numri i përgjithshëm i dosjeve të shpallura, brenda periudhës së inspektimit, numrin e dosjeve të dorëzuara brenda afatit ligjor dhe numrin e dosjeve të padorëzuara ende deri në datën 15 maj 2023 dhe del shuma e përgjithshme e dosjeve të padorëzuara e cila është 909. Në bazë të kësaj shume u përllogarit me përqindje për afatet 21-30 ditore, 31-60 ditore, 61-90 ditore, 91- 20 ditore dhe



nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar.



Sikurse u trajtua dhe në rubrikën e analizës ligjore të këtij raporti, një nga problematikat e konstatuara gjatë inspektimit është mënyra e organizimit dhe realizimit të detyrave nga administrata gjyqësore në gjykatat objekt inspektimi. Kjo e lidhur me mënyrën e organizimit të punës, realizimit të detyrave nga stafi përgjegjës i administratës gjyqësore, përgjegjësia e sekretarit të seancës për dorëzimin e dosjes, si dhe e sekretarit gjyqësor për plotësimin e librit të pasqyrimit të lëvizjes së dosjeve. Nga kontrolli i të dhënave të vendosura në dispozicion nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, gjatë inspektimit, u hasën problematikat e mëposhtme:

1. Rezultuan mospërputhje të datave të dorëzimit në kryesekretari të dosjeve me vendimet përfundimtare me datat e komunikimeve të vendimeve palëve ndërgjyqëse. Për disa çështje gjyqësore rezultoi që dosje të padorëzuara në sekretari kishin komunikim vendimesh (*e cila sipas informacionit të marrë gjatë inspektimit u është dhënë palëve dorazi nga sekretarja e seancave*).
2. Në regjistrin e vendimeve (numërori i vendimeve) data e dorëzimit të dosjes është e pashoqëruar nga firma e kryesekretares ose sekretares së caktuar me këtë detyrë në zbatim të nenit 19; 20 e vijues të rregullores së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë miratuar me Urdhrin nr. 209, datë 27.10.2017 të Kryetarit të Gjykatës. Kjo passjell mos mbajtje të përgjegjësisë mbi shënimin e datës së dorëzimit të dosjeve në kryesekretari.
3. Rezultoi se afati i njoftimit të vendimeve nga sekretaria gjyqësore pas dorëzimit të dosjeve nga sekretari seancës është maksimumi 5 (pesë) ditore, duke mbajtur parasysh ngarkesën e ditës ose pushimet zyrtare dhe përgjithësisht nuk vërehen vonesa në veprimet administrative të gjykatës. Rezultoi se 2.7 % e dosjeve për të cilat Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit

120-218 ditore. Nga kjo përlllogaritje doli që mesatarisht për periudhën 21-120 ditore, të jenë dorëzuar 89 % e vendimeve të shpallura dhe të përfunduara tej afatit ligjor.

[Signature]

[Signature]

- të Përgjithshëm Tiranë është shprehur me vendim përfundimtar, ende nuk janë dorëzuar nga gjyqtari përkatës për të vijuar me komunikimin e vendimeve dhe pritjen e afateve të ankimit.
4. Rezultoi se pas inspektimit në vend të grupit të inspektimit, në rikonfirmimin e të dhënave të dërguara nga gjykata një dosje gjyqësore e deklaruar e dorëzuar dhe njoftuar vendimi i plotë palëve, nuk është dorëzuar ende nga gjyqtari i çështjes, konkretisht flitet për vendimin nr. 6248, datë 24.11.2022.
 5. Rezultoi se në tre raste edhe pse vendimi është shpallur në seancë gjyqësore me tjetër datë, nuk është numërtuar në regjistrin e numërorit të vendimeve sipas rendit kronologjik, por është harruar dhe numërtuar në datë tjetër kronologjike por me të njëjtën datë shpallje sipas seancës gjyqësore. Konkretisht janë: vendimi nr. 4866, datë 21.09.2022 i cili është numërtuar në datën 28.09.2022, vendimi nr. 5926, datë 08.11.2022 dhe vendimi nr. 5927, datë 08.11.2022, Të dy këto vendime janë numërtuar në datën 11.11.2022. Në çdo rast janë plotësuar shënimet nga kryesekretarja e gjykatës nëpërmjet një procesverbali i cili i është bashkëlidhur regjistrin të numërtimeve të vendimeve për këtë anomali në regjistrin e numërtimeve të vendimeve.
 6. Rezultoi se, mungesa e një regjistri për regjistrimin e komunikimeve të vendimeve sipas datave të nisura nga kryesekretaria pasjell paqartësi në evidentimin e datës së komunikimit të vendimeve, pasi dosjet e çështjeve konkrete ndodhen në apel dhe nuk janë në arkivën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm për të përcaktuar datën e saktë të komunikimit të vendimit. Në informacionin e nisur nga kjo gjykatë ekzaktësisht janë 32 dosje.
 7. Rezultoi se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, nuk ka të dhëna të sakta për mënyrën e trajtimit të vendimeve të komunikuar palëve, duke bërë të pamundur nxjerrjen e këtij informacioni edhe nga vetë gjykata. Ekzistenca e një regjistri në të cilën do të shënoheshin data dhe dita e komunikimit të secilit vendim do të lehtësonte punën e administratës gjyqësore dhe njohjen e palëve të interesuara mbi këto të dhëna.
 8. Evidentohet fakti se në shumicën e rasteve në gjykatat objekt inspektimi është e pamundur të identifikohet momenti i kalimit të dosjes me vendimin e arsyetuar nga gjyqtari tek sekretari i seancës, për pasojë dhe respektimi i afateve procedurale për dorëzimin e dosjeve në sekretarinë gjyqësore nga sekretari i seancës.
 9. Rezultoi se të dyja gjykatat e inspektuara treguan gatishmëri në bashkëpunimin për këtë inspektim tematik.

IV. Konkluzionet

- Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë evidentohet fakti se në shumicën e rasteve është e pamundur të identifikohet momenti i kalimit të dosjes me vendimin e arsyetuar nga gjyqtari tek sekretari i seancës, për pasojë dhe respektimi i afateve procedurale për dorëzimin e dosjeve në sekretarinë gjyqësore nga sekretari i seancës.
- Nga inspektimi i kryer rezultoi se për periudhën 01.09.2022 deri më 31.12.2022 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë shpallur 1228 vendime gjyqësore,



të cilat janë dorëzuar të gjitha në kryesekretarinë e kësaj gjykate. Nga këto 1147 vendime ose 93.5% e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit ligjor 7 ditor, 67 vendime ose 5.4 % e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda 10 ditëve, 13 vendime ose 1% e totalit të vendimeve të shpallura janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari brenda 18 ditëve dhe vetëm 1 vendim i shpallur është depozituar i arsyetuar në sekretari brenda 107 ditëve. Numri i gjyqtarëve sipas organikës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është 16, ndërsa numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë gjatë vitit 2022 është 12.1;

- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka numrin më të madh të çështjeve të mbartuara (backlog) për gjykatat e rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm, duke filluar me vitin 2019 me 37% të totalit të çështjeve të mbartura, në vitin 2020 me 42% të totalit, në vitin 2021 me 53% të totalit të çështjeve të mbartura, po ashtu ka numrin më të madh të çështjeve të reja të regjistruara, duke evidentuar vetëm vitin 2022, në 34,382 çështje të reja ose 36% e totalit për gjykatat e rrethit gjyqësor;
- Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk ka funksionuar me organikë të plotë, pasi faktikisht ka 39 gjyqtarë ose 52 %, pra gjysmën e organikës së saj, në raport me organikën 76 gjyqtarë (numrin e gjyqtarëve sipas dekretit). Kjo gjykatë ka funksionuar me 52% të numrit të gjyqtarëve që duhet të ketë sipas dekretit. Ngarkesa mesatare e një gjyqtari në këtë gjykatë ka qenë 1361 çështje;
- Totali i vendimeve të shpallura nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për periudhën kohore 01.09.2022 deri më 31.12.2022 është 2613 vendime, nga të cilat të dorëzuara brenda afatit ligjor 20 ditor janë 1632 vendime ose 62.5 %. Të dorëzuara brenda afatit 21-30 ditor janë 201 vendime ose 7.7 %; Të dorëzuara brenda afatit 31-60 ditor janë 377 vendime ose 14.4 %; të dorëzuara brenda afatit 61-90 ditor janë 154 vendime ose 5.9 %; të dorëzuara brenda afatit 91-120 ditor janë 78 vendime ose 3%; të dorëzuara brenda afatit 121-218 ditor janë 99 vendime ose 3.8%; të padorëzuara deri në datën 15.5.2023 janë 72 vendime ose 2.7 %;
- Numri total i vendimeve të dorëzuara me vonesë jashtë afatit ligjor të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është 909 vendime ose 35 % e vendimeve totale, (në të cilat nuk përfshihen 72 vendime të padorëzuara në sekretari deri më datë 15.05.2023), nga totali i vendimeve të shpallura 2613. Rezulton se, pjesa më e madhe e vendimeve janë dorëzuar brenda afatit 31-60 ditor, në masën 41 % të totalit, duke vijuar me 22% të vendimeve brenda afatit 21-30 ditor, 17 % të vendimeve brenda afatit 61-90 ditor, 11 % të vendimeve brenda afatit 121-128 ditor dhe duke përfunduar me 9 % të vendimeve brenda afatit 91-120 ditë;
- Duke marrë në konsideratë ngarkesën mesatare të një gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me 1361 çështje, e cila ndikon në kohëzgjatjen e çështjeve të përfunduara, në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve të shpallura në

sekretari rezulton se brenda afatit 120 ditor janë dorëzuar 89 % të vendimeve e shpallura.

- Në rastin konkret, rezulton *prima facie* se, pavarësisht afateve të parashikuara në ligjin procedural civil (neni 308 i K. Pr. Civile), këto afate në shumicën e rasteve nuk janë zbatuar me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Në këtë rast, mosrespektimi i afateve procedurale nga ana e magjistrateve nuk duhet të konsiderohet *apriori* si një shkelje e mundshme disiplinore. Për të arritur në konkluzionin nëse nga ana e magjistratëve janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e tyre profesionale duhet të analizohen rast pas rasti nëpërmjet një procesi verifikimi apo hetimi disiplinor një sërë çështjesh të cilat kanë të bëjnë me identifikimin e elementeve faktikë dhe juridikë mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Jo në çdo rast mosrespektimi i afateve të përcaktuara nga ana e legjislacionit procedural dhe në mënyrë të veçantë afatet e parashikuara për të dorëzuar brenda një afati të arsyeshëm vendimet e arsyetuara do të konsiderohet si shkelje e mundshme disiplinore. Që këto shkelje të konsiderohen si të tilla duhet të ketë një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, apo aftësie profesionale të tilla që kalojnë “*kufirin e të arsyeshmes*” dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet nga ana e magjistratit. Vonesa në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve përbën shkelje disiplinore gjithashtu kur përbën rast përsëritës, të rëndë dhe të pajustificuar, si dhe në të njëjtën kohë nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor.
- Duke patur parasysh ndryshimet që solli reforma në sistemin e drejtësisë dhe efektet e saj, veçanërisht lidhur me plotësimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata dhe numrin e madh të çështjeve në pritje për t’u shqyrtuar në kuadër të vlerësimit të kohëzgjatjes së procedurave në lidhje me arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore duhet të tregohet një qasje sa më e kujdesëshme. Ngarkesa në punë që shoqëron sot magjistratët, lidhur edhe me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, është një kriter objektiv që mbahet parasysh me numrin total të çështjeve civile dhe kohën e nevojshme për të arsyetuar vendimet gjyqësore të dhëna, ndaj dhe bazuar në këtë kriter objektiv, koha që i është dashur magjistratëve për të arsyetuar vendimet gjyqësore i shërben jo vetëm rritjes së cilësisë në aspektin përmbajtësor të vendimit gjyqësor të dhënë në drejtim të palëve ndërgjyqëse që ky vendim i drejtohet, por edhe forcimit të besimit të publikut për një gjykim të drejtë, ku thelbi i këtij parimi është një vendim gjyqësor i mirëarsyetuar.
- Në këtë kuadër, për të arritur në konkluzionin nëse nga ana e magjistratëve janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e tyre profesionale duhet të analizohen rast pas rasti nëpërmjet një procesi verifikimi apo hetimi disiplinor të gjitha rastet ku afati i arsyetimit dhe dorëzimit të vendimit gjyqësor tejkalon afatin i cili konsiderohet si një “*kohë e arsyeshme*” që i nevojitet



gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar.

- Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se, 89 % e vendimeve janë dorëzuar brenda afatit 120 ditor¹ duke u konsideruar kështu në shumicën e rasteve, si koha e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar. Pra, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se, 89 % e vendimeve janë dorëzuar brenda afatit 120 ditor
- Në këto kushte, paraprakisht vlerësohet se deri në momentin e kryerjes së inspektimit, afati përcaktues dhe i domosdoshëm që duhet të merret në konsideratë, është afati 120 ditor si koha e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar, pasi vetëm ky afat mund të bëjë dallimin dhe të shërbëjë si një kohë e arsyeshme në situatën konkrete të ngarkesës, organikës dhe numrit të magjistrëve, apo tipologjisë së çështjeve të gjykuara, mes nevojës për të arsyetuar dhe dorëzuar të gjitha vendimet gjyqësore sipas afatit të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile dhe mundësisë dhe kapaciteteve aktuale të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të respektuar këtë afat.

V. Rekomandimet

1. Për gjykatat subjekte të inspektimit:

- Raporti i inspektimit t'i njoftohet gjykatave të inspektuara në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese me qëllim njohjet me problematikën e konstatare.
- Rekomandohet që libri i pasqyrimin të lëvizjes së dosjeve të mbajë datën e dorëzimit të dosjes nga gjyqtari tek sekretari i seancës, datën e dorëzimit nga sekretari i seancës tek sekretari gjyqësor, të numërohet në çdo fletë, të nënshkruhet nga kancelari/sekretari i seancës/sekretari gjyqësor.
- Rekomandohet mbajtja e një regjistri për njoftimin e vendimit palëve në të cilin të evidentohet data e njoftimit të vendimit, me qëllim realizimin e kërkesave ligjore të nenit 171 dhe nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile, të cilët parashikojnë se vendimet përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e vendimit ose, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda 3 (tre) ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar.

2. Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë

Referuar gjetjeve të inspektimit vlerësohet se ka të dhëna lidhur me fakte që nëse provohen përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuar sipas ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte rekomandohet:



- 1) Fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për magjistratë gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për vendimin e shpallur, i cili është depozituar i arsyetuar në sekretari brenda 107 ditëve nga shpallja.
- 2) Fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për magjistratë gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vendimet e shpallura e të dorëzuara të arsyetuara në sekretari pas 120 ditëve nga shpallja.
- 3) Fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për magjistratë gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vendimet e shpallura e të padorëzuara në sekretari deri në datën 15.05.2023.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 147/d, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 194, pika 4 dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, të ndryshuar,

PROPOZOJMË:

1. Përfundimin e inspektimit tematik të nisur me vendimin nr. 6/4, datë 13.04.2023, *“Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhomës Civile dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”*, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Caktimin e periudhës nga data 05.10.2023 deri në datën 05.04.2024, si periudhë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.
3. Të njoftohet Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë për përfundimin e inspektimit tematik, duke iu dërguar edhe një kopje të Raportit të Inspektimit.
4. Të njoftohet Këshilli i Lartë Gjyqësor mbi rekomandimet e lëna gjykatave të inspektuara në lidhje me librat e pasqyrimin të lëvizjes së dosjes dhe regjistrin për njoftimin e vendimit.

INSPEKTORËT

Erjena Bashari



Joana Asimi

